



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË

Nr. _____ Prot.

Ersekë, më _____.____.2021

SKENAR

I FATKEQËSISË NATYRORE, LIDHUR ME PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

BASHKIA KOLONJË

KRYETARI

Erion Isai

Punoi: Specialisti i ECK
M. GORA

Mars 2021

Institucioni: Bashkia Kolonjë

Organizatat pjesëmarrëse:

- Institucionet e bashkisë Kolonjë;
- Institucionet e tjera vendore;
- Partner në zbatimin e projektit 4PLUS - Instituti i Kërkimeve Urbane
- Komuniteti

Grupi i synuar: Personat me aftësi të kufizua (PAK)

Natyra dhe dita e zhvillimit: Simulim i një operacion kërkim shpëtimi, data 13/11/2021

Qëllimi: Garantimi i mbrojtjes së jetës, pronës së personave me aftësi të kufizuar

Objektiv:

1. Dhënia e ndihmës dhe shpëtimi i jetës së njerëzve, pronës nga ndikimi i rrezikut të zjarrit;
2. Realizimi në kohë i ndërhyrjes duke arritur bashkëpunimin dhe bashkërendimi i forcave që vepronë në operacionin e ndërhyrjes dhe eliminimin e shpejtë të pasojave.

Lloji i ushtrimit: Trajtim teorik dhe veprime praktike në terren.

TAKIM ORIENTUES

Për realizimin e këtij simulimi do të jetë e nevojshme të realizohet një takim orientues me të gjitha strukturat e parashikuara që do të marrin pjesë në realizimin e ushtrimit.

Qëllimi i një takimi orientues është të diskutojë, konsiderojë dhe azhurnojë dokumentet ekzistuese të planifikimit të emergjencave, strukturat organizative dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe të njoh personelin kryesor me procedurat e emergjencës dhe përgjegjësitë e tyre në zbatimin e tyre.

Kjo mund të bëhet përmes diskutimeve të përgjithshme që mund të mbahen nga drejtoria e Emergjencave në bashki. I gjithë personeli me një rol në planin ose procedurën e emergjencës duhet të marrë pjesë.

Gjatë këtij takimi duhet të caktohen:

- Plan operacional duke detajuar hap pas hapi radhën e veprimeve dhe kohën e ndërhyrjes së çdo grupi.

Baza Ligjore:


- Ligji nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore";
- Ligji nr.152/2015, "Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi";
- Ligji nr.45/2019, "Për Mbrojtën Civile";
- VKM nr.835, datë 03.12.2004 "Për miratimin e planit kombëtar të emergjencave civile";
- Ligji nr.121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 202", etj.

PËRSHKIMI I SKENARIT

Ushtrimi mund të simulohet në një **objekt banimi** ose në **një zonë pyjore** (gjatë organizimit të një feste/pikniku në familje - për të shmangur një grupim të madh).

Skenari A (në rastin e zjarrit në një objekt banimi)

Nga një banor i qytetit është bërë lajmërimi në **numrin 128** të stacionit të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri, bashkia Kolonjë, se në bllokun nr. 3, të qytetit Ersekë në një banesë të pallatit dykatësh, afër kryqëzimit ka rënë zjarr. Gjatë komunikimit me këtë strukturë banori ka vënë në dukje se në banesë jeton një person me aftësi të kufizuar.



Sinjalizimi: 30 minuta (koha e fillimit dhe përfundimit të ushtrimit)

Skenari B (në rastin e zjarrit në pyje)

Nga një banor i qytetit është bërë lajmërimi në **numrin 128** të stacionit të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri, bashkia Kolonjë, se në zonën pranë Kabashit/Prroit të Vranishtes (shembull) të qytetit Ersekë, ka rënë zjarr.

Gjatë komunikimit me këtë strukturë banori ka vënë në dukje se gjatë përgatitjes së barbeque në një piknik familjare, një pemë ka marr flakë dhe ka nisur të përhapet, gjithashtu është shprehur se pjesë e piknikut është edhe një person PAK me karrocë.



Sinjalizimi: 30 minuta (koha e fillimit dhe përfundimit të ushtrimit)

PROCEDURAT E NEVOSHME

Lajmërimi për fatkeqësinë e stimuluar: Strukturat e EC në Prefekturën Korçë, AKMC Tiranë, Drejtoria e MZSH Tiranë, Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Vendndodhja e ekipit kontrollues: Pranë institucionit të bashkisë Kolonjë

➤ Strukturat operuese që marrin pjesë në përballimin e situatës së zjarrit të rënë

1. Strukturat e njësisë vendore të bashkisë Kolonjë

- Shërbimi vendor i MZSH;
- Policia e shtetit;
- Shërbimi i urgjencës mjekësore dhe strukturat e tjera të shërbimit shëndetësor;
- Sektori i emergjencave civile;
- Personeli i policisë bashkiake;
- Strukturat e shërbimit social të bashkisë;
- Strukturuarat vullnetare të bashkisë Kolonjë.

2. Institucioni i Prefektit të Qarkut

- Struktura të emergjencave Civile

3. Ministria e Mbrojtjes

- Agjencia Kombëtare e mbrojtjes Civile
- Qendra Kombëtare Operacionale

4. Ministria e Brendshme

- Drejtoria e MZSH-së

Kapacitetet e forcave të ndërhyrjes operacionale

- Shërbimi i MZSH ka në përbërje 14 personel dhe 4 mjete zjarrfikëse - *Numri i forcave zjarrfikëse në gatishmëri është 3 punonjës në ditë;*
- Policia e Shtetit ka në përbërje 34 personel dhe 4 automjete - *Numri forcave të gatshme në qytet është 4 punonjës në ditë;*
- Urgjenca mjekësore e spitalit - *Numri i personelit 104 dhe i ambulancave 5 dhe numri i forcave të gatshme 11 nga të cilët 2 mjek dhe 9 infermierë;*
- Sektori i emergjencave civile në bashki përbëhet nga 2 punonjës - *Numri i personelit 2 punonjës;*
- Struktura e policisë bashkiake në bashki përbëhet nga 10 punonjës - *Numri i forcave të gatshme në qytet 3 punonjës;*
- Struktura të shërbimit social në bashki përbëhet nga 9 punonjës - *Numri i personelit të gatshëm 4 punonjës;*
- Shërbimi vullnetar në bashki 25 veta - *Numri i personelit vullnetar në situatë 5 veta.*

➤ **Skema e lajmërimit**

- Lajmërimi i strukturave të MZSH-së, ose nr. pa pagesë 128;
- Njoftimi i kryetarit, nënkryetarëve;
- Njoftimi i strukturave që do të angazhohen në përballimin e situatës.

➤ **Shpërndarja e informacionit**

- Komisionit Vendor të Mbrojtës Civile në bashkinë Kolonjë;
- Komisionit të Planifikimit dhe Mbrojtjes Civile, në Prefekturën Korçë;
- Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në Ministrinë e Mbrojtjes;
- Qendrës Kombëtare të Kërkim Shpëtimit në Ministrinë e Mbrojtjes.

➤ **Mjetet e komunikimit**

Lidhja me autoritetet do të realizohet me anë të mjeteve të sigurta të përhershme me: telefon nëpërmjet rrjetit të komunikimit Vodafone, One, Telekom shqiptar.

➤ **Organizimi, mënyra, burimet**

Strukturat operacionale kanë si funksion kryesor mbrojtjen e jetëve njerëzore, pronën private. Këto struktura do të jenë nga burime njerëzore e material të drejtuara nga Kryetari i bashkisë ose nënkryetarit, të cilat i janë deleguar detyrat. Gjithashtu dhe strukturat e tjera që do të angazhohen në situatë, do të veprojnë me shpejtësi dhe në mënyrë kompakte për vënien nën kontroll të vatrës së zjarrit, por dhe për të ndihmuar në zhvendosjen e përkohshme të personave dhe pasurisë me qëllimin e vetëm mbrojtjen e tyre.

MENAXHIMI I SITUATËS

Për menaxhimin e situatës do të krijohen këto grupe veprimi:

1. **Grupi i shuarjes së zjarrit**, i cili ka për detyrë shuarjen e zjarrit, shpëtimin e jetëve njerëzore dhe pronës.
2. **Grupi i kërkim shpëtimit**, i cili ka për detyrë që nëpërmjet veprimeve operuese me forcat mjetet, pajisjet zjarrfikëse, të ndërhyjë për shuarjen e vatrës së zjarrit, si dhe të evakujë dhe shpëtojë jetë njerëzore dhe pronën.
3. **Grupi i evakuimit**, i cili ka për detyrë lëvizjen e organizuar të njerëzve, ruajtjen e vlerave material në një vend më të sigurt.

➤ **Mjetet që do përdoren gjatë operacionit**

Mjete të bashkisë: 2 mjete zjarrfikëse, 1 autoveturë dhe 1 kamion për lëvizjen e pajisjeve të ndryshme shtëpiake.

Mjete të spitalit: 1 autoambulancë që vepron për transportimin e të dëmtuarve dhe dhënien e ndihmës së parë.

Mjete të policisë: 1 automjet.

Gjatë skenarit përbërja e grupeve

1. Grupi i shuarjes së zjarrit (8 persona)

- Efektivi i MZSH.
- 4 persona me mjetet, pajisjet dhe metodat taktike do ndërhyjnë për shuarjen e zjarrit.
- 3 forca të tjera të MZSH do ndërhyjnë për evakuimin dhe shpëtimin e jetëve njerëzore dhe pronës.

2. Grupi i shpëtimit

- Efektivi i MZSH (3) radha e veprimeve nga shefi i MZSH.
- Efektivi i policisë bashkiake (2), ndërmerr veprime për shpëtimin e jetëve të rrezikuara. Bën kufizimin e vendit për të parandaluar rrezikimin e të tjerëve. Marrin masa sigurie për personat në nevojë.
- Policia e shtetit (3) merr masa për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike, merr masa për qarkullimin normal të mjeteve dhe sigurojnë lëvizjen e mjeteve që bëjnë evakuimin e personave, si dhe atyre që merren me furnizimin.

3. Grupi i evakuimit

- Personeli i EC (1) ndërhyr për evakuimin e personave.
- Personeli i Urgjencës Mjekësore jep ndihmën e parë dhe kur shikon që gjendja po përkeqësohet bën transportimin për në spitalin e qytetit
- Personeli i shërbimit social (3) kujdeset për vendosjen e personave pranë qendrës sociale të qytetit. Organizojnë punën për ofrimin e paketave ushqimore, veshmbathjeve dhe materialeve të tjera të domosdoshme.
- Personeli i policisë bashkiake, merr masa sigurie për personat në nevojë.

- Strukturat vullnetare japin ndihmesën në evakuimin e materialeve dhe mjeteve të ndryshme.

➤ **Detyrat e një nga specialistëve të EC në rastin e situatës emergjente të ndodhur**

1. Ndjek në vazhdimësi situatën në terren.
2. Përgatit materialet për mbledhjen e KVMC.
3. Raporton për situatën dhe propozon masat përkatëse për përballimin e situatës.
4. Raporton situatën pranë Sektorit të përballimit të mbrojtjes civile në prefekturë
5. Dërgimi i plan kërkesave për nevojat që ka për përballimin e situatës.

➤ **Plani i sigurisë në rast evakuimi**

Vendstrehimi qendra e shërbimit social “Motrat Qirjazi”.

GJATË SIMULIMIT

- Shpërndarje e leaflets informuese mbi projektin dhe procedurat standarde të shpëtimit;
- **Video** dhe **foto** të simulimit.